



# Ditët e Orientimit Shqiptar 2017

Jemi të lumtur t'ju ftojmë në garën e trete të orientimit në Shqipëri!

**Nga data 22 deri më 24 Shtator 2017**

**Gara e tretë ndërkombëtare 3 ditore e orientimit në Rajonin e Tiranës, Shqipëri**

**Organizimi:** Orienteering Club Albania OCA

**Me Mbështetjen e:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Dajti express

**Drejtuesi i gares:** Wolfgang Pötsch (Austri)

**Menaxheri i gares:** Inge Bosina (Shqipëri/Austri-Naturfreunde Wien)

**Hartë bëresi:** Ondrej Pijak, Valter Soler (Sllovakia); – Dajti, Kepi Rodonit, Inge Bosina  
- Qyteti Studenti

**Planifikuesi i kursit:** Wolfgang Pötsch (Austri)

**Qendra e garës:** Hotel TeStela, Tiranë, Shqipëri, shikoni <http://testela.al>

**GPS: 41.356163 N, 19.745264 E**

**Programi i mundur:**

**E Enjte, 21 Shtator 2017**

Mbërritja, regjistrimi, sistemimi

Qendra e gares e hapur nga 12:00 deri në 21:00

**15:00 – 16:00** -Mundësi trajnimi në Parkun i Madh i Tiranës

Vëndtakimi: Hyrja parkun, afër Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT)

**E Premte, 22 Shtator 2017**

9:00-11:00 -Hapja e qendrës së garës

13:00 -Pika e takimit në Malin e Dajtit në stacionin teleferik, /Hotel Dajti

14:00 -Nisja e parë në distance të mesme

**E Shtune, 23 Shtator 2017**

11:00 -Qendra e gares e hapur tek Kepi i Rodonit

Vëndtakimi në Kepi i Rodonit, brenda zonës në pronësi të Misionit Françeskan në plazh

12:00 -Nisja e pare në distance të gjatë


**E Dielë, 24 Shtator 2017**

9:30 -Takimi në Shkolla 9-vjeçare Osman Myderizi (Labinoti), Rr. Drago Siliqi, afër Rr. Pjetër Budi në Qyteti Studenti.

10:00 -Nisja e parë sprint në Tiranë

12:00 -Ceremonia e dhënies së çmimeve (ose pas fundit të garës, nëse është herët)

## Hartë përmbledhëse:



**Distances: Airport**  
Tiranë – Qender 12km

Tiranë -Dajti Teleferiku  
5km

Tiranë –Kepi Rodonit  
ca. 60km

## Kategoritë e klasave për pjesëmarrje:

Në varësi të regjistrimeve do të publikojmë kurset në faqen tonë pas afatit të regjistrimeve, si dhe kohëzgjatjen e tyre.

**Regjistrimet e vona** do të jenë të mundura deri në momentin e vendtakimit.

## Pagesa për pjesëmarrje mbas afatit (për te huajt):

Të treja garat për 75€.

Për garat teke: 30€ për në Dajt (përfshirë teleferikun), 30€ për në Kep të Rodonit duke përfshirë transportin, e nëse ka ende vënde të lira, 25€ për sprintin.

Klasat e hapura: 20€ për në Dajt (përfshirë teleferikun), 20€ për në Kep të Rodonit duke përfshirë transportin, e nëse ka ende vënde të lira, 15€ për sprintin.

## Për shqiptarët janë të vlefshme ofertat e mëposhtme:

Garë teke: 500L

Për teleferikun: 600L

Për transport deri në Kep të Rodonit 500L nëse do ketë vënde të lira.

## Programi i detajuar:

### E Enjte, 21 Shtator 2017

Mbërritja, regjistrimi, sistemimi

Secili grup do marrë një “Pako Mirëseardhjeje” me një hartë trajnimi, grykashkë nisjeje, faturën e pagesës, harta dhe informacione të tjera të vlefshme.

Të gjithë kush kanë prenotuar me paketë të plotë do të merren nga aeroporti e do të dërgohen në hotel. Të gjithë të tjerët do të marrin pakon e tyre në hotel, nëse na dërgojnë adresën e tyre ose mund ta marrin në Hotel Stela.

15:00 – 16:00 –Mundësi trajnimi në Parkun e Tiranës, **GPS: 41,316650N, 19,819578E**

Terreni: park qyteti me pyll, shkalla e hartës: 1:4 000, distancë e barabartë 5m.  
Tipi: urdhër i lirë i pikat kontrollit, flamurë prej letre.

### Etapa 1 - E Premte, 22 Shtator 2017

9:00-11:00 Hapja e qendrës së garës

#### Vendodhja:

Mali Dajtit, Linzë, rreth 6km në veri-lindje të qendrës së Tiranës.

Hyrje me teleferikun – stacioni fushor GPS: 41.350705N, 19.860854E

Shihni faqen: <http://dajtiekspres.com/v1/>

Bileta për teleferikun do jetë e përfshirë në pagesën e regjistrimit. Ju do e merrni atë në pakon e mirësearchjes ose në zyrën e biletarisë.

Kohëzgjatja me teleferik: 15 minuta.


**13:00** -Pika e takimit në Malin e Dajtit në stacionin teleferik, /Hotel Dajti.

**14:00** -Nisja e parë në distance të mesme.

**Shkalla e hartës:** 1:7 500 distancë e barabartë 5m

#### Terreni ditën e parë,distanca të mesme:

Vendi do të jetë tek „Ballkoni i Dajtit“, pjesë e nje vendi të sheshtë midis pjeses se pjerret dhe kulmit. Pyjet e bukura me pemë të vjetra, disa shtigje, lehtësime të ndryshme, disa here shkembinj të thepisur të cilat rrethojne terrene të ndryshme si terrene gjysmë te hapur dhe të hapur, më mundesi shumë të mirë vrapimi.



**Kujdes:** Ka shumë bunker përreth, shpesh të rrethuar nga hendekë të thellë, të cilat mund të jenë të fshehura nga bimësia. Prandaj vëzhgoni ku hidhni hapat dhe kini mëndjen ku shkoni!

Bëni kujdes pranë terreneve ushtarake – hyrjes së ndaluar - , gardhet janë shpesh jo qartësisht të dukshme. Mbani distancë ndaj të gjitha ndërtesave, instalimeve në këtë zonë.



Dajti Hotel



## Etapa 2 - E Shtunë, 23 Shtator 2017

**11:00** Vëndtakimi në Kepi i Rodonit, brenda zonës në pronësi të Misionit Françeskan në plazh.

GPS: 41.582997N, 9.458429E

**12: 00** Nisja e parë në distancë të gjatë.

Do ketë 2 nisje:

Nisja e 1 për kurset e gjata. Në baticë të ulët përgjatë detit (me shumë mundësi, por jo e sigurtë) 1,5 km.

Përndryshe 2,5 km (do të mendojmë për transportin, nëse do të kërkohet).

Nisja e 2 afër zonës së finish-it

**Shkalla e hartës:** 1:10 000 (Kep: 1:4 000), distancë e barabartë 5m

**Terreni dita e dyte, distanca te gjata:** Kepi i Rodonit  
Është nje vend mjaft i bukur i cili është i rrethuar nga Deti Adriatik. Terreni është i hapur dhe gjysme i hapur me mundësi vrapimi të mirë, pjesë më shumë bimesi të dendur, pyje, humnera të pjerrta (jo për vrapim!) me pamje të bukura të detit. Në këtë faze ju duhet të kujdeseni për të mos harruar pamjet befasuese që do të keni nga gara. Zona finale do të jetë tek plazhi. Në të njejten kohe ju do të mesoni historine e Shqiperise tek nje kishe që nga shekulli 12 dhe rrenojat e kalase Skenderbeut .



### Vëmendje:

Kepi i Rodonit përbëhet kryesisht prej shtresave ranore dhe është mjaft i përthyer, prandaj përdorni vetëm këpucë me ose pa thumba Dobb.

Ka disa pjesë ku kufijtë e tokës janë duke u thyer, prandaj ju lutem bëni kujdes ku shkoni dhe mos u afroni tepër pjesëve të shënuara me të zezë në hartë.

Përgjatë gjithë rrugës për në "landsend" gjenden shtigje, ndonjëherë të fshehura përmes bimësisë. Bëni me kujdes zgjedhjet tuaja të rrugës!



zona e finishit

### Etapa 3 - E Dielë, 24 Shtator 2017

Parkimi në hyrjen e Qyteti Studenti nga Rr. Elbasanit, rruga e shënuar tek nisja me një hartë nxemje rreth 600m.

**9:30** -Takimi në Shkolla 9-vjeçare Osman Myderizi (Labinoti), Rr. Drago Siliqi, afër Rr. Pjetër Budi në Qyteti Studenti (do të ofrojmë transport për rrobat/bagazhet tuaja në finish).

**10:00** -Nisja e parë sprint në Tiranë

**12:00** -Ceremonia e dhënies së çmimeve (ose pas fundit të garës, nëse është herët)

**Shkalla e hartës:** 1:4 000, distancë e barabartë 5m

#### Terreni dita e trete, Sprint:

Tirana, Qyteti Studenti,

Kjo garë do të jetë për ato të cilet pelqejnë për të sfiduar garën e sprintit.

Kjo pjese e Tiranës përbëhet nga ndertesa që nga koha e komunizmit dhe më nje labirint rrugesh, shpesh duke mbaruar në rrugehyrje, hapësira të hapura pa ndertesa, bllokime, dhe pjesa e universitetit më blloqe të medha dhe parqe.



#### Informacione të përgjithshme:

- Sistemi i vulosjes (Sistemi i kontrollit): Sport ident, SI-qira 2€ për garë, çmimi për blerje sipas kërkesës. Ju lutem të jepni numrin e kartës SI në momentin e regjistrimit
- garat do të organizohen në përputhje me rregullat e IOF
- të gjithë garuesit marrin pjesë në garë nën përgjegjësinë e tyre të plotë; organizuesi ofron vetëm ndihmën mjekësore bazë në mbërritje. Pjesëmarrësit nuk sigurohen nga organizuesi, për dëmet që i shkaktojnë vetes ose personave të tjerë.
- Në rast të anulimit të garës për motive që nuk lidhen me organizuesin, organizuesi nuk mban asnjë përgjegjësi.
- Të gjithë garuesit bien dakord që nga momenti i regjistrimit për publikimin e fotove të tyre gjatë evenimentit dhe të rezultateve në faqen e internetit. Përndryshe ju lutemi të informoni organizuesin në momentin e regjistrimit.

- Ju lutemi të lexoni me kujdes të gjithë informacionin e organizmit dhe atë që përmban ky njoftim.
- **Kujdesi ndaj fëmijëve:** do të organizohet një kopsht falas gjithashtu dhe një kurs për fëmijët – **vetem sipas kërkeses**

#### **Paketat:**

Për ta bërë sa më të lehtë e të mundur pjesëmarrjen tuaj, kemi përgatitur disa oferta të plota me çmime ku përfshihet tarifat e garave, transfertat, akomodimi, mengjes, dhe udhëtimet për ta njohur më mirë Shqipërinë.

Paketat baze për akomodimin në Tirane:

Çmimi përfshin:

- Tarifën e garës
- Transporti nga Aeroporti në akomodimin tuaj dhe anasjelltas, si dhe tek zonat e gares.
- 2 netë në hotel sipas kategorisë së zgjedhur
- Mëngjesi

Kategori	Çmimi i paketave	Suplementi për dhomë teke
Hotel më 4 yje	200€ p.P.	€ 80,00
Hotel i thjeshtë	150€ p.P.	€ 40,00
Hostel	120€ p.P.	

Paketa në hotele 5 yje, në kamping si dhe akomodimi në vende të tjera, si p.sh. në bregdet sipas kërkesës.

Për grupe ne do të bëjme nje pakete special.

#### **Informacion i rëndësishem:**

Pas AOD 2017 mund te njifeni me 3 gara orientimi të tjera në MOCPA në Prilep të Maqedonis. Për më shumë informacion kontaktoni në <http://speleo.mk/mocpa/>

#### **Programi Turistike:**

Përveç ketyre paketave themelore që në ofrojme për të organizuar udhetime neper Shqiperi. Për më teper ne do të kemi kenaqesine të organizojme për ju udhëtimin tuaj personal permes Shqiperise, në nje varg për të vizituar vendet arkeologjike e cila do të udhëhiqet nga nje arkeolog deri në turnet e udhezuar në male ose qendrimin në plazh sipas dëshires suaj!

Për më shumë informacion në lidhje me ofertat e tjera i gjeni në faqen tonë të internetit.

Informacion:

Website: <http://orienteering-al.com>

Mail: [info@orienteering-al.com](mailto:info@orienteering-al.com)

Ju falenderojmë që keni kontribuar në “Projektin e Orientimit Shqiptar” me pjesëmarrjen tuaj!

**Mirëseerdhët Shqiptarë!**

**Mirëseerdhët në Shqipëri dhe Maqedoni!**